


Raport mbi punën e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit

(janar-qershor 2020)

Autorë: Martina Ilievska, Misha Popoviq



Projekti "Monitorimi i Suksesit të Punës së Komisionit Shtetëror për Mbrojtje nga Korrupsioni" është financuar nga Fondacioni Shoqëri e Hapur - Maqedoni. "Përmbajtja është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe e grantit, dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se shpreh pikëpamjet dhe qëndrimet e Fondacionit Shoqëri e Hapur - Maqedoni.

Impresum

Titull: Raporti mbi punën e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (janar-qershor 2020)

Autorë: Martina Ilievska, Misha Popoviq

Botues: Instituti për Demokraci "Societas Civilis" – Shkup

Design: Matea Londza Shumkovska

Publikimi mund të shkarkohet falas në:

<http://www.idscs.org.mk>

Projekti "Monitorimi i Suksesit të Punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsioni" është financuar nga Fondacioni Shoqëri e Hapur – Maqedoni.

Përmbajtja është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe e grantit, dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se shpreh pikëpamjet dhe qëndrimet e Fondacionit Shoqëri e Hapur – Maqedoni.

CIP – Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

005.584.1:[35.072.2:343.352(497.7)]2020*01/*06"(047.31)

ILIEVSKA, Martina

Raporti mbi punën e Komisionit Shtetëror për parandalimin e korrupsionit : (janar-qershor 2020) / autorë Martina Ilievska, Misha Popoviq. – Shkup : Instituti për demokraci "Societas Civilis", 2020. – 26 стр. : табели, граф. прикази ; 30 см

Фусноти кон текстот. – Публикацијата е во рамки на проектот: "Monitorimi i suksesit të punës së Komisionit Shtetëror për mbrojtje nga korrupsioni". – Rezyme. – Библиографија: стр. 24

ISBN 978-608-266-001-1

1. Popovikj, Misha [автор]

а) Државна комисија за спречување на корупција -- Мониторинг на работењето -- Македонија -- 2020*01/*06 -- Истражувања

COBISS.MK-ID 52632837

Përmbajtja

Rezyme	4
Puna e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit në vitin e parë të përbërjes së re	5
Rrjeti i fushave të cënueshme	6
Analiza e rezultateve të fituara nga monitorimi	10
Qasja metodologjike	18
Lista e shkurtesave	23
Bibliografia	26

Rezyme

Monitorimi i strukturuar i Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit jep një përmbledhje rreth progresit në punën e përbërjes së re të Komisionit, i cili punon në kuadër të kompetencave të tij në lidhje me proceset e krijimit të politikave, monitorim dhe mbikëqyrje, si dhe bashkëpunim me organet e tjera shtetërore për parandalimin e korrupsionit.

Monitorimi i KSHPK në kuadër të projektit është i ndarë në dy faza kohore. Faza e parë është nga fillimi i vitit, janar 2020, deri në mes të vitit kalendarik, përkatësisht deri më 30 qershor 2020. Faza e dytë e monitorimit do të jetë për gjysmën e dytë të vitit 2020.

Subjekt i analizës janë vendimet e marra nga Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit në periudhën nga janari deri në 30 qershor 2020. Numri i përgjithshëm i vendimeve të analizuar të Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit është **N=196**.

Shumica e vendimeve të marra janë në fushën e shërbimeve të përgjithshme publike

Vendimet të cilat KSHPK i ka marrë në muajt e parë të vitit 2020 janë kryesisht në fushën e **shërbimeve të përgjithshme publike 37%**. Shërbimet e përgjithshme publike janë fusha që është më e gjerë dhe i përmban të gjitha vendet e cënueshme nga organet ekzekutive dhe legjislative për të cilat nuk ka të dhëna specifike në vendimin, për t'u përfshirë në ndonjë nga fushat e tjera.

KSHPK-ja mori më shumë vendime për procedurat e punësimit

Në gjysmën e parë të vitit 2020, Komisioni mori më shumë vendime për kundërvajtje dhe shkeljet e rregullave në lidhje me korrupsionin ose konfliktin e interesit **gjatë punësimit**, të cilat janë pothuajse gjysma, përkatësisht **46%** e numrit të përgjithshëm të vendimeve.

Në një të tretën e çështjeve, KSHPK-ja nuk kishte elementet për të filluar procedurë.

Në pothuajse një të tretën e rasteve (30%), KSHPK-ja konstatoi se nuk kishte kompetencë ose elementë të mjaftueshëm për të filluar procedurë. Në 51% të rasteve ku është konstatuar konflikt interesi, i njëjti është tërhequr gjatë procedurës.

Shumica e procedurave filluan me iniciativën të parashtruesit të njohur

Pothuajse gjysma e vendimeve (49%) i referohen nismave të filluara nga **parashtrues i njohur**. Në 26% të vendimeve thuhet se të njëjtat janë iniciuar nga parashtrues i panjohur. Në periudhën e analizuar, 11% e vendimeve të miratuara u referohen procedurave të iniciuara me iniciativë vetanake të KSHPK-së.

Duhen mesatarisht nëntë muaj për të gjithë procedurën, nga iniciativa deri te vendimi

Periudha mesatare nga paraqitja e iniciativës deri në marrjen e vendimit, në mbledhjet e

fundit, në gjysmën e parë të vitit 2020 është 9 muaj dhe 3 ditë. Numri minimal i ditëve për një procedurë të plotë është 29 ditë, ndërsa numri maksimal i regjistruar në periudhën e monitoruar, është 457 ditë.

Puna e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit në vitin e parë të përbërjes së re

Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit në përbërjen e re ka funksionuar për më shumë se një vit, përkatësisht nga 8 shkurt 2019. Në pajtim me Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktin e interesave, komisioni është i pavarur në kryerjen e detyrave të përcaktuara me ligj dhe ka vetinë e personit juridik, me përbërje kryetar dhe gjashtë anëtarë.¹ KSHPK-ja, ka një sërë kompetenca dhe autorizime, të cilat kanë të bëjnë me proceset e krijimit të politikave, monitorim dhe mbikëqyrje, si dhe bashkëpunim me organet e tjera shtetërore me qëllim parandalimin e korrupsionit. Në kuadër të autorizimeve, komisioni mund të fillojë procedurë para organeve kompetente për shkarkimin, sistematizimin, ndryshimin ose zbatimin e masave të tjera të përgjegjësive, si dhe procedurë për ndjekje penale të personave të zgjedhur dhe të emëruar ose personave zyrtarëve në organet e administratës publike.²

Komisioni përgatit raport vjetor për punën dhe ia paraqet Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Raporti përmban të dhëna për aktivitetet e kryera nga KSHPK-ja, në dhjetë muajt e parë të funksionimit.

Sipas të dhënave të përfshira në raportin vjetor, nën dyshimin e shkeljes së ligjit, 1 172 raporte janë dorëzuar në KSHPK nga subjekte të ndryshme (qytetarë, organizata dhe institucione), ndërsa përveç kësaj 245 lëndë janë hapur me iniciativë të tyre. Numri më i madh i denoncimeve ishin për dyshime për veprime korruptive 687 denoncime dhe 23 lëndë me iniciativë të tyre, ndërsa për dyshim për konflikt interesi ishin iniciuar 364 procedura të filluara në bazë të denoncimeve dhe 66 me iniciativë të tyre, për mosrespektim të ndalimeve gjatë procesit zgjedhor kanë pasur 57 raste (54 denoncime dhe 3 me iniciativë të tyre).

Për më tepër, Komisioni punoi në kontrollimin e gjendjes pronësore të 220 personave të zgjedhur dhe të emëruar. Në kuadër të kompetencave të tij, është kryer rishikim anti-korrupsion i 8 ligjeve.

Gjatë vitit 2019, KSHPK-ja u përfshi në mënyrë aktive në zhvillimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit ndërsa të njëjtën e miratoi komisioni në mbledhje. Për shkak të krizës politike dhe shpërndarjes së Kuvendit për zgjedhjet e parakohshme parlamentare, strategjia ende nuk është votuar nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut.³

¹ Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konflikt të interesave, Numri i Gazetës Zyrtare: 12/2019 (nenet 9 dhe 10)

² Kocevski, G. (2019) Towards accountable and transparent public administration by means of functional oversight institutions. Fondacioni Shoqëria e Hapur - Maqedoni.

³ Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, Republika e Maqedonisë së Veriut, Raporti Vjetor për punën e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit për vitin 2019, qershor 2020. Qasur më: [://www.dksk.mk/fileadmin/user_upload/2020/Godishen_izveshta_za_rabotata_na_DKSK_-_2019.pdf](http://www.dksk.mk/fileadmin/user_upload/2020/Godishen_izveshta_za_rabotata_na_DKSK_-_2019.pdf) (vizita e fundit: 10 korrik).

Matrica e fushave të cenueshme

Që nga fillimi i punës së përbërjes së re të KSHPK-së, ata përballen me rritje të ngarkesës së punës si rezultat i denoncimeve. Në masë të madhe, kjo është një shenjë pozitive e besimit në institucionin dhe pritjes së rezultateve. Mirëpo, njëkohësisht, kjo paraqet rrezik, sepse ekziston mundësia që KSHPK-ja të përqendrohet në raste të vogla dhe të punojë sipas iniciativës së saj, pa kohë të caktuar.

Së këndejmi, Platforma për organizata civile për luftë kundër korrupsionit ka zhvilluar përmbledhje të fushave të cenueshme nga korrupsioni, si propozim - vende ku është e nevojshme të drejtohet vëmendja e institucioneve, duke filluar me KSHPK-në. Këto fusha të cenueshme, thjesht thënë janë vende ku mund të ndodhë korrupsioni. Si vend, vendndodhjen e përcakton fusha (shembull: shëndetësia) dhe dimensionet horizontale ku më shpesh ndodhin shkelje (në financat publike, punësim, krijimi i rregullave dhe në mbikëqyrje).

Identifikimi i zonave të cenueshme u bë përmes anketimit të 16 ekspertëve nga fusha e luftës kundër korrupsionit. Për secilën nga fushat, është pyetur (1) sa ka gjasë të ndodhë korrupsion, (2)

sa është dëmi mbi shoqërinë nëse ndodh dhe (3) sa është efekti shoqëror i korrupsionit në fushat, por për secilin dimension horizontal, veç e veç. Të gjitha pyetjet janë shkallë vlerësimi prej 1 në 10 ku 10 do të thotë probabiliteti më i lartë dhe dëm, në mënyrë përkatëse sipas pyetjeve.

Lista e fushave është marrë nga klasifikimi i funksioneve të shtetit, si listë gjithëpërfshirëse e funksioneve të cilat kryejnë institucionet. Kjo listë përmban 11 fusha të gjera, dhe një listë të gjatë të nën-fushave, që mundëson gjatë anketimit të sigurohen të dhëna më specifike.

Gjatë kalkulimit të zonave të cenueshme, fillohet me vlerësimet mesatare të ekspertëve për efektet në secilën fushë përmes perspektivës së dimensioneve horizontale ku mund të ndodhë korrupsioni. Që në fazën e parë, vërehet përparësi e qartë e fushave - vendin kryesor e zënë zonat e rrezikuara në shëndetësi, kompetencat dhe marrëdhëniet me biznesin privat, mbrojtjen e mjedisit jetësor, rendin dhe sigurinë publike (ku është vendosur edhe gjyqësori) dhe shërbimet e përgjithshme publike, ku janë organet ekzekutive pa një fushë specifike dhe dhoma ligjvënëse.

Tabela 1. Vlerësimet mesatare të dëmit nga korrupsioni - mesatarja ndërmjet fushave dhe dimensioneve horizontale

	Ndikimi mbi rregullativën	Financat publike	Punësimi	Mbikëqyrje
Shërbimet e përgjithshme publike	7.1	8.6	7.9	7.1
Mbrojtje	5.3	6.6	6.6	5.9
Rendi dhe siguria publike	6.6	7.4	7.7	7.1
Aktivitetet ekonomike	7.9	8.8	7.9	8.1
Mbrojtja e mjedisit jetësor	7.7	8.0	6.8	8.3
Çështjet e banimit dhe çështje komunale	5.5	6.5	5.4	6.3
Shëndetësi	7.0	8.7	8.3	7.8
Rekreacion, kulturë dhe religjion	5.2	6.4	6.1	5.3
Arsim	6.5	6.8	8.4	6.5
Mbrojtja sociale	5.9	6.9	7.0	6.3

Mirëpo, duke marrë parasysh se po flasim për fusha të gjera, ekspertët kanë vlerësuar në mënyrë specifike gjasat për paraqitjen e korrupsionit dhe dëmit shoqëror në nivelin e nën-niveleve. Përmbledhur në nivel të fushave, vlerësimet tregojnë situatë të ngjashme me

hartën e mëparshme të zonave të cenueshme. Dallimi ndodh në fushat e rendit dhe sigurisë publike (për shkak të gjyqësorit) dhe mbrojtjes së mjedisit, për shkak të dëmit të madh që mund të shkaktohet në atë fushë vetëm me një rast

Tabela 2. Mundësia për paraqitjen e korrupsionit dhe dëmtimit të supozuar

	Dëmi	Probabiliteti
Shërbimet e përgjithshme publike	7.4	7.1
Mbrojtje	5.4	4.9
Rendi dhe siguria publike	8.2	7.8
Aktivitetet ekonomike	7.9	7.7
Mbrojtja e mjedisit jetësor	8.2	7.5
Çështjet e banimit dhe çështje komunale	7.0	6.9
Shëndetësi	8.5	8.2
Rekreacion, kulturë dhe religjion	6.0	6.5
Arsim	6.5	6.0
Mbrojtja sociale	6.1	6.1

Faza përfundimtare në ndërtimin e matricës së zonave të cënueshme është kombinimi i dy fazave të mëparshme. Kështu, faktorët e dëmshmërisë dhe probabilitetit shumëzohen me vlerat e Tabelës 1 që do

të shtohen si aspekte të llogaritjes së cënueshmërisë. Matrica përfundimtare është paraqitur më poshtë, ndërsa vlerat zëvendësohen me rangimin e tyre për dukshmëri më të madhe.

Tabela 3. Matrica e zonave të cënueshme (vlerat janë rangu i rezultateve përfundimtare të cënueshmërisë)

Rangimi	Ndikimi mbi rregullativën	Financat publike	Punësimi	Mbikëqyrje
Shërbimet e përgjithshme publike	20	15	18	19
Mbrojtje	40	37	37	39
Rendi dhe siguria publike	16	13	6	14
Aktivitetet ekonomike	10	4	10	8
Mbrojtja e mjedisit jetësor	12	6	17	5
Çështjet e banimit dhe çështje komunale	24	22	26	23
Shëndetësi	9	1	2	3
Rekreacion, kulturë dhe religjion	36	31	32	35
Arsim	29	24	21	29
Mbrojtja sociale	34	28	27	33

Sipas analizës së ekspertëve, tre zonat kryesore më të rrezikuara janë financat, punësimi dhe mbikëqyrja në shëndetësi. Menaxhimi me financat në lidhje me biznesin privat është zona e katërt e rëndësishme e ndjeshmërisë, veçanërisht duke pasur parasysh ndihmën shtetërore të dhënë gjatë kësaj periudhe. Kjo pasohet nga mbikëqyrja mbi mbrojtjen e mjedisit jetësor si zonë e rrezikuar, ndërsaq menjëherë pas

kësaj vijon punësimi në organet e rendin publik dhe sigurinë (përfshirë gjyqësorin).

Duke pasur parasysh këtë matricë të cënueshmërisë, KSHPK-ja duhet të drejtojë punën e saj në këto zona, përkatësisht të akordojë burime për të kryer prova dhe analiza në institucione të caktuara në këto zona. Me këtë, KSHPK-ja, do të rrisë punën me iniciativën e vet.

Analizë e rezultateve të fituara nga monitorimi

Shumica e vendimeve të marra janë në fushën e shërbimeve të përgjithshme publike

Vendimet të cilat KSHPK-ja, ka marrë në muajt e parë të vitit 2020 janë kryesisht në fushën e **shërbimeve të përgjithshme publike**⁴, 37%, shumica e tyre janë ngritur nën dyshimin se shkelja ka ndodhur në ndonjë nga **organet ekzekutive dhe legjislative**⁵, 90%.


Shumica e rasteve në fushën e shërbimeve të përgjithshme publike i referohen procedurave gjatë punësimit dhe kontrollit të rregullt të KSHPK-së mbi listat anketuese për gjendjen pronësore të bartësve të funksioneve publike.

19% e vendimeve të marra janë nga fushat arsim dhe fusha **rendi dhe siguria publike**⁶, ndërsa 11% kanë të bëjnë me fushën **aktivitetet ekonomike**⁷.

Në pesë muajt e parë të analizuar të vitit 2020, asnjë nga vendimet e marra nga KSHPK-ja, nuk i referohet disa fushave mbrojtje dhe mbrojtja e mjedisit jetësor.

Një përmbledhje e hollësishme, sipas fushës së vendimeve të marra nga KSHPK-ja që janë lëndë e analizës, janë paraqitur në Grafikon 1.

Grafikon 1. Fushat e vendimeve të marra nga KSHPK-ja



⁴ Në nënfushën „organe ekzekutive dhe organet legjislative” bëjnë pjesë më shumë organe të pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ si zyra në të gjitha nivelet e qeverisjes, staf këshillimor, administrativ dhe politik për të cilat nuk ka të dhëna të qarta në vendimin e KSHPK-së dhe nuk mund të përfshihen në fusha të veçanta.

⁵ Me „organe ekzekutive dhe legjislative” nënkuptohen të gjitha institucionet që janë pjesë e pushtetit ekzekutiv ose legjislativ të shtetit.

⁶ Shërbimet policore - menaxhimi i punëve dhe shërbimeve policore; shërbime për mbrojtje nga zjarri; gjykatat, prokuroritë, burgjet.

⁷ Institucionet që merren me bujqësi, pylltari, gjueti dhe peshkim, karburant dhe energji, minera, prodhim dhe ndërtim, transport, komunikim, grante, hua, subvencione, import dhe eksport tregtar.

Arsimi - i ndjeshëm ndaj korrupsionit dhe konfliktit të interesit, në të gjitha nivelet

Sipas ndryshimit në metodologjinë për monitorimin e punës së KSHPK-së, u shtua një variabël e varur "nën-fushë", e cila tregon më hollësisht se ku në vetë fushën ka ndodhur dëmtimi i mundshëm.

Monitorimi tregoi se shumica e denoncimeve janë në nën-fushën **organe ekzekutive dhe organe legjislative**- 34% nga numri i përgjithshëm i vendimeve të marra.


Në fushën e Rendit Publik dhe Paqes, vërehen vendime në dy nga katër nën-fushat, **shërbimet e policisë**⁸ - 5% dhe **gjykatat** -14% të numrit të përgjithshëm të vendimeve të marra.

Sipas rezultateve të fituara, mund të shihet se ka dyshime për korrupsion dhe konflikt interesi në arsim në të gjitha nivelet, sepse janë iniciuar procedura dhe janë marrë vendime për të gjitha nivelet e arsimit.

Nga numri i përgjithshëm i vendimeve të marra, 6% i referohen nën-fushave, arsimit parashkollor dhe fillor, arsimit të mesëm dhe arsimit të lartë, ndërsa 2% i referohen arsimit të mesëm profesional dhe specializimit të lartë.

Një përmbledhje e hollësishme, sipas fushës së vendimeve të marra nga KSHPK-ja, që janë lëndë e analizës, janë paraqitur në grafikonin 2.

Grafikun 2. Nën-fushat e vendimeve të miratuara të KSHPK-së



⁸ Me "Shërbime policore" nënkuptohen aktivitetet e mëposhtme: shërbime, përfshirë regjistrimin e imigrantëve të paligjshëm, mirëmbajtjen e të dhënave në lidhje me punën e policisë, rregullimin dhe kontrollin e trafikut rrugor, parandalimin e kontrabandës dhe kontrollin

Paraqitje e kryqëzuar e rezultateve që janë subjekt i analizës sipas fushave dhe nën-fushave të KSHPK-së, është paraqitur në tabelën 4.

Tabela 4. Paraqitje e kryqëzuar e fushave dhe nën-fushave

Shërbimet e përgjithshme publike	Organet ekzekutive dhe legjislativë [66 vendime]	Çështje financiare dhe fiskale [6 vendime]	Punë të jashtme	Ndihmë ekonomike e huaj	Transaksionet e borxhit publik	Transfertat e llojit të përgjithshëm midis niveleve të ndryshme të qeverisjes	Zona të tjera të papërmendura
Mbrojtje	Mbrojtja ushtarake	Mbrojtja civile	Ndihmë ushtarake e huaj				
Rendi dhe siguria publike	Shërbimet e policisë [10 vendime]	Mbrojtje nga zjarri	Gjykatat [27 vendime]	Burgje			
Aktivitetet ekonomike	Aktivitetet e përgjithshme ekonomike	Bujqësi, pylltari, gjueti dhe Peshkim	Karburant dhe energji	Miniera, prodhim dhe ndërtimtari	Transporti	Komunikime	
Mbrojtja e mjedisit jetësor	Menaxhimi i mbeturinave	Menaxhimi me ujërat e ndotura	Reduktimi i ndotjes	Mbrojtja e biodiversitetit			
Çështjet e banimit dhe çështje komunale	Zhvillimi i banimit [2 vendime]	Zhvillimi i komunitetit	Furnizim me ujë	Ndriçimi rrugor			
Shëndetësi	Produkte, aparate dhe pajisje mjekësore	Shërbime spitalore për pacientë të jashtëm	Shërbimet spitalore	Shërbime shëndetësore publike [14 vendime]			
Rekreacion, kulturë dhe religjion	Shërbime për rekreacion dhe sport	Shërbime nga kultura [3 vendime]	Shërbimet e transmetimit dhe botimit [1 vendim]	Shërbime fetare dhe shërbime të tjera të komunitetit			
Arsim	Arsimi parashkollor dhe fillor [12 vendime]	Arsimi i mesëm [11 vendime]	Arsim i mesëm profesional dhe specializim i lartë- [4 vendime]	Arsimi i lartë [11 vendime]			
Mbrojtja sociale	Sëmundje dhe invaliditet	Pleqëri [1 vendim]	Mbrojtja e personave në prag të ekzistencës	Familja dhe fëmijët [1 vendim]	Papunësia	Ekonomi familjare	Përrjashtim tjetër shoqëror [1 vendim]
Funksione të tjera të papërmendura të qeverisë qendrore dhe lokale	Funksione të tjera [2 vendime]						

Pothuajse gjysma e vendimeve të marra kanë të bëjnë me procedurat në lidhje me punësimin ose marrëdhëniet e punës


Në gjysmën e parë të vitit 2020, Komisioni mori më shumë vendime për procedurat që lidhen me korrupsionin ose konfliktin e interesit gjatë punësimit, të cilat janë pothuajse gjysma, përkatësisht **46%** e numrit të përgjithshëm të vendimeve. Monitorimi i institucionit në vitin 2019 gjithashtu tregoi se më shpesh vendimet kanë të bëjnë me probleme në lidhje me punësimin, përkatësisht ndërmjet muajit mars

dhe shtator 42% kishin të bënin me punësimin, ndërsa 46% në tre muajt e fundit të vitit të kaluar.

Vendimet e tjera i referohen procedurave në lidhje me financat publike 13%, si dhe keqpërdorimit / shkeljes së funksionit themelor të institucionit 13%.

Një përmbledhje e detajuar sipas llojit të shkeljeve në vendimet e marra nga KSHPK-ja, që janë lëndë e analizës jepet në Grafikon 3. (të dhënat janë paraqitur në %)

Grafikon 3. Paraqitje sipas llojit të shkeljeve në vendimet e marra nga KSHPK-ja (shprehur në%)



Komisioni Shtetëror në 7% të rasteve ka konstatuar parregullsi dhe shkelje të ligjit

Komisioni gjatë procedurës (nga fillimi i iniciativës deri në marrjen e vendimit) mund të kërkojë të dhëna nga institucione të tjera kompetente gjatë procedurës dhe / ose t'i drejtohet personit ose institucionit për të cilin është iniciuar iniciativa. Gjatë gjithë procesit, në 30% të iniciativave KSHPK-ja, ka zbuluar se nuk kishte kompetencë, në 17% se nuk kishte elementë të mjaftueshëm për të filluar procedurën, ndërsa në 13% të rasteve zbuloi se një institucion tjetër kompetent, tashmë kishte vepruar.


Kur bëhet fjalë për konflikt interesi, gjatë procedurës komisioni mund t'i kërkojë personit që të heqë

konfliktin pas çka e ndërpret procedurën. Kjo ndodhi në 5% të procedurave në gjysmën e parë të vitit 2020.

Vetëm në 7% të rasteve u përcaktua se kishte shkelje të ligjit, ndërsa në 5% ishte lëshuar urdhër pagese për shkelje të ligjit për shkak të mangësive ose mospërputhjeve në pyetësonin anketues të paraqitur të detyrueshëm për të gjithë bartësit e funksioneve publike.

Përmbledhje e detajuar sipas statusit të vendimit të miratuar në vendimet e miratuara nga KSHPK-ja, që janë lëndë e analizës, është dhënë në Grafikon 4. (të dhënat janë paraqitur në %)

Grafikon 4. Pasqyrë sipas statusit të vendimit të marrë në vendimet e miratuara nga KSHPK-ja (treguar në%)



Më tepër shkelje të konfirmuara të ligjit janë në fushat: aktivitete ekonomike dhe arsim

Nëse bëhet krahasim midis fushave dhe statusit të vendimit të miratuar, do të shihet se shkelje është identifikuar në katër fusha nga 5 raste në fushat e veprimtarive ekonomike dhe arsimit, në një rast në fushën e shërbimeve të përgjithshme publike dhe në dy raste në fushën e rendit dhe sigurisë publike.

Komisioni, gjithashtu konstatoi se në 26 nga procedurat e hapura një institucion tjetër tashmë

kishte vepruar (para ose gjatë procedurës së KSHPK-së). Institucionet e tjera kompetente tashmë kanë vepruar në 10 raste në fushën e shërbimeve të përgjithshme publike, 8 në fushën e rendit dhe sigurisë publike 3 dhe në 4 në fushën e arsimit.

Përmbledhje e detajuar sipas numrit të vendimeve, krahasim i fushës dhe statusit të vendimeve të miratuara nga KSHPK-ja, që janë lëndë e analizës, tregohet në tabelën 5 (të dhënat janë paraqitur me numrin e rasteve).

Table 5.

Fusha dhe statusi		STATUSI												
		NUK KA TË DHËNA TË MJAFTËSHME / NUK KA ELEMENT	E PA PRANUAR / E REFUZUAR	PROCEDURË E KONFIRMUAR, E MIRATUAR, E MËTEJSHME	NDRYSHIMI I GJENDJES FAKTIKE	NUK KA KOMPETENCË	NUK KA KORRUPSION / KONFLIKT INTERESI	KUNDËRVAJTËSE	E PAVLEFSHME	VËREJTJE PUBLIKE	NUK KA LËNDË	MATURIMI I LËNDËS	KONFLIKTI I INTERESIT ËSHTË HEQUR	VEPRUAR NGA NJË INSTITUCION TJETËR
F U S H A	SHËRBIMET E PËRGJITHSHME PUBLIKE	18	2	1	3	10	18	7			1	3	10	
	MBROJTJE													
	RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE	5		2	1	8	12		2			1	8	
	AKTIVITETET EKONOMIKE	3		5	1	1	6					1	2	3
	MBROJTJA E MJEDISIT JETËSOR													
	ÇËSHTJET E BANIMIT DHE ÇËSHTJE KOMUNALE					1	1							
	SHËNDETËSI	1			1		7	2				1	2	
	REKREACION, KULTURË DHE RELIGJION	1				1							1	1
	ARSIM	6		5	2	2	11	1	2		1	2	2	4
	MBROJTJA SOCIALE		1			1	1							
	TJETËR	1					2							

Pothuajse gjysma e vendimeve të marra në gjysmën e parë të vitit 2020 u iniciuan nga një parashtrues i njohur


Pothuajse gjysma (49%) e vendimeve që janë subjekt i analizës në periudhë, u referohen iniciativave që janë iniciuar për shkak të paraqitjes nga një paraqitës i njohur. Në 26% të vendimeve thuhet se ato janë iniciuar me iniciativë të një parashtruesi të panjohur

13% dhe një parashtruesi i cili ka paraqitur iniciativën në mënyrë anonime.

Në 11% të rasteve, komisioni filloi të punojë në raste sipas iniciativës së vet.

Përmbledhje e hollësishme sipas iniciuesit të procedurave të KSHPK-së që janë subjekt i analizës jepet në Grafikon 5.

Grafikon 5. Përmbledhje sipas iniciuesit të procedurave të KSHPK-së (të dhënat janë paraqitur në %)




KSHPK-së mesatarisht i duheshin nëntë muaj dhe tre ditë nga fillimi i procedurës deri në miratimin e vendimit

Periudha mesatare nga paraqitja e iniciativës deri në marrjen e vendimit, për dy seancat e fundit, në gjysmën e parë të vitit 2020 është **9 muaj dhe 3 ditë**. Numri minimal i ditëve për një procedurë të plotë është 29 ditë, ndërsa numri maksimal i regjistruar në periudhën e monitoruar, është 457 ditë.

Kjo periudhë përfshin procedurën përgatitore për të përcaktuar nëse ka elemente për një procedurë, veprime procedurale gjatë procedurës për përcaktimin e situatës faktike dhe marrjen e vendimit në seancë publike të KSHPK-së.

Përmbledhje e hollësishme e ditëve për marrjen e vendimeve nga KSHPK-ja, të cilat janë objekt i analizës jepet në Grafikon 6. (të dhënat janë paraqitur në %)

Grafikon 6. Përmbledhje e ditëve për marrjen e vendimeve nga KSHPK-ja (të dhëna janë paraqitur në %)



Mean 273.67 Minimum 29.00 Maximum 457.00

Qasja metodologjike

Qëllimi kryesor i monitorimit të punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit janë disa komponentë kryesore. E para është përmes monitorimit të vazhdueshëm dhe të strukturuar të shihet progresi, por gjithashtu të jetë bazë për dhënien e rekomandimeve për vendosjen e prioriteteve gjatë punës dhe vendosjen e fokusit ndaj kategorive të cenueshme.

Përbërja aktuale e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit ka punuar për një vit në kuadër të kompetencave të saj në lidhje me procesin e krijimit të politikave, monitorim dhe mbikëqyrje, si dhe bashkëpunimin me organet e tjera shtetërore për parandalimin e korrupsionit.

Vendimet të cilat i merr Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit janë baza për monitorimin e punës së institucionit. Monitorimi i KSHPK-së, në kuadër të projektit është i ndarë në dy faza kohore. Faza e parë është nga fillimi i vitit, janar 2020, deri në mes të vitit kalendarik, përkatësisht deri më 30 qershor 2020. Faza e dytë e monitorimit do të jetë për gjysmën e dytë të vitit 2020.

Të dhënat mbi të cilat mbështetet raporti janë mbledhur nga ueb faqja e Komisionit Shtetëror për

Parandalimin e Korrupsionit dhe janë informacione të disponueshme për publikun. Janë analizuar vendimet e miratuara nga KSHPK-ja, në periudhën janar-qershor 2020 në 5 seanca të mbajtura.

Përshkrimi i analizës së mostrës

Subjekt i analizës janë vendimet e miratuara nga Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit në periudhën nga janari deri në 30 qershor 2020. Numri i përgjithshëm i vendimeve të analizuara të Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit është **N=196**.

Përshkrimi i variablave

Vendimet analizohen në përputhje me fushën në të cilën kishte qëllime për korrupsion ose konflikt interesi, llojet e shkeljeve, statusin e procedurës (çfarë është vendosur nga KSHPK-ja) kush e ka iniciuar procedurën para KSHPK-së dhe kohëzgjatjen e tërë procedurës. Përmbledhje e hollësishme e variablave që janë subjekt i analizës jepet në tabelat nga numri 6 deri në numrin 10.

Tabela 6 - Fushat

SHËRBIMET E PËRGJITHSHME PUBLIKE	MBROJTJE	RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE	AKTIVITETET EKONOMIKE	MBROJTJA E MJEDISIT JETËSOR	ÇËSHTJET E BANIMIT DHE ÇËSHTJE KOMUNALE	SHËNDËTËSI	ARGËTIMI, KULTURA DHE FEJA	ARSIM	MBROJTJA SOCIALE	FUNKSIONE TË TJERA TË PAPËRMENDURA TË QEVERISË QENDRORE DHE LOKALE
----------------------------------	----------	---------------------------	-----------------------	-----------------------------	---	------------	----------------------------	-------	------------------	--

Tabela 7 - Nënfishat

Organet ekzekutive dhe legjislatve	Mbrojtja ushtarake	Shërbimet e policisë	Aktivitetet e përgjithshme ekonomike	Menaxhimi i mbeturinave	Zhvillimi i banimit	Produkte, aparate dhe pajisje mjekësore	Shërbime për rekreacion dhe sport	Arsimi parashkollor dhe fillor	Sëmundje dhe invaliditet	
Çështje financiare dhe fiskale	Mbrojtja civile	Mbrojtje nga zjarri	Bujqësi, pylltari, gjueti dhe peshkatari	Menaxhimi me ujërat e ndotura	Zhvillimi i komunitetit	Shërbime spitalore për pacientë të jashtëm	Shërbime nga kultura	Arsimi i mesëm	Pleqëri	
Punë të jashtme	Ndihmë ushtarake e huaj	Gjykatat	Karburant dhe energji	Reduktimi i ndotjes	Furnizim me ujë	Shërbimet spitalore	Shërbimet e transmetimit dhe botimit	I mesëm profesional dhe i specializim i lartë	Mbrojtja e personave në prag të ekzistencës	
Ndihmë ekonomike e huaj		Burgje	Miniera, prodhim dhe ndërtimtari	Mbrojtja e biodiversitetit	Ndriçimi rrugor	Shërbime shëndetësore publike	Shërbime fetare dhe shërbime të tjera të komunitetit	Arsimi i lartë	Familja dhe fëmijët	
Transaksionet e borxhit publik			Transporti						Papunësia	
Transfertat e llojit të përgjithshëm midis niveleve të ndryshme të qeverisjes			Komunikime						Ekonomi familjare	
									Përfundim tjetër shoqëror	

Tabela 8 - Lloji i shkeljes i përcaktuar në përputhje me vendimet e marra nga KSHPK

Ndikimi mbi rregullativën	Rastet kur ndikohet në krijimin e rregullave, politikave ose standardeve për të arritur interesin privat.
Financat publike	Nënkuptohen raste kur për të arritur interesin privat, paratë publike keqpërdoren përmes prokurimit publik, subvencioneve, grumbullimit, etj.
Punësimi	Nënkuptohen rastet kur interesi privat ushtrohet përmes punësimit, siç janë rastet e klientelizmit, nepotizmit dhe patronimi.
Mbikëqyrje	Nënkuptohen raste kur interesi privat realizohet përmes presionit mbi strukturat mbikëqyrëse ose abuzimit sistematik, dobësimit ose shfuqizimit të tyre.
Grumbullimi i funksioneve	Nënkupton raste kur një person kryen ose emërohet në dy ose më shumë funksione.
Kontrolli i interesave dhe pronës	Listat anketuese, mosparaqitja, mos plotësimi i tyre
Funksionet kryesore të institucionit	Shkelja është shkaktuar mbi funksionin themelor të institucionit
Tjetër	Lloji i lëndimeve që nuk janë përfshirë më parë nga kategorizimi

Tabela 9 - Statusi i vendimit të miratuar

Nuk ka të dhëna të mjaftueshme / nuk ka element	Nuk ka të dhëna dhe elementë të mjaftueshëm për të filluar procedurë para organeve të tjera
Nuk është pranuar / e refuzuar	Procedurat e refuzuara dhe / ose të pa pranuar
Procedurë e konfirmuar, e miratuar, e mëtejshme	Ka konfirmim për shkeljen e ligjit, lënda është në procedurë të mëtejshme
Ndryshimi i gjendjes faktike	Gjatë procedurës situata faktike ndryshoi, procedura mbyllet
Nuk ka kompetencë	KSHPK-ja, nuk ka autoritet të ndërmarrë veprime
Nuk ka korrupsion / konflikt interesi	Është vërtetuar se nuk ka korrupsion ose konflikt interesi
E pabazuar, e pakonfirmuar	Indikacionet e cekura në aplikacionin e paraqitur janë të pabazuara ose të pakonfirmuara
Kundërvajtëse	Është shqiptuar masë, kallëzim për kundërvajtje dhe urdhër pagesë
Refuzohet	Çështja është refuzuar nga KSHPK-ja
E pavlefshme	Procedura është e pavlefshme
Vërejtje publike	Është shqiptuar masa vërejtje publike
Nuk ka lëndë	Është konstatuar se për procedurën nuk mund të iniciohet lëndë
Maturimi i lëndës	Çështja është mbyllur për shkak të maturimit të saj
Konflikti i interesit është hequr	Gjatë procedurës së KSHPK-së, është bërë ndryshim dhe konflikti i interesit u hoq
Vepruar nga një institucion tjetër	Në rrjedhë është procedurë ose është vepruar nga një institucion tjetër për të njëjtën lëndë / dyshim.

Tabela 10 - Inicimi i procedurës

Inicativë vetanake	Procedura është filluar me iniciativë të KSHPK-së
Parashtrues anonim	Denoncimi u paraqit nga parashtrues anonim
Parashtrues i njohur	Denoncimi u paraqit nga parashtrues i njohur
Informacione nga mediat	Procedura është filluar sipas informacioneve të fituara nga mediat
Posta elektronike	Denoncimi është bërë përmes postës elektronike
Detyrë zyrtare	Procedura u iniciua sipas detyrës zyrtare të KSHPK-së
Parashtrues i panjohur	Denoncimi u paraqit nga parashtrues i panjohur
Parti politike	Denoncimi u paraqit nga parashtrues i panjohur
Nuk ka informacion	Nuk ka asnjë informacion në vendimet se si është iniciuar procedura
Aktiviteti i KSHPK-së	Është pjesë e aktiviteteve të planifikuara (vjetore) të KSHPK-së

Lista e shkurtesave

Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit - KSHPK

Kontrolli i legjislacionit kundër-korrupsion - KLK

Ligji për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit - LPKKI

Bibliografia

Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, Republika e Maqedonisë së Veriut, Raporti Vjetor për punën e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit për vitin 2019, qershor 2020. Qasur më: https://www.dksk.mk/fileadmin/user_upload/2020/Godishen_izveshta_za_rabotata_na_DKSK_-_2019.pdf (vizita e fundit: 10 korrik).

Enti Shtetëror Statistikor, Republika e Maqedonisë së Veriut, Klasifikimi i Funksioneve të Qeverisë, <http://www.stat.gov.mk/KlasifikaciiNomenklaturi/KlasifikacijaFunkciiVlada.pdf> (vizita e fundit: 10 korrik).

Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konflikt interesi, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut”: 12/2019

Ilievski, I. (2019). "Raporti i parë mbi punën e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit." Instituti për Demokraci "Societas Civilis" - Shkup. <<https://idscs.org.mk>>

Ilievski, I. (2020). "Raporti i parë mbi punën e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit." Instituti për Demokraci "Societas Civilis" - Shkup. <<https://idscs.org.mk>>

Kocevski, G. (2019)

Towardsaccountableandtransparentpublicadministrationbymeansoffunctionaloversightinstitutions.
Fondacioni Shoqëria e Hapur - Maqedoni.

Vendimet e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit janë në dispozicion në linkun në vijim <<https://www.dksk.mk/index.php?id=113>>.

